



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 2153/1 Prot.

Tiranë, më 20/2 / 2024

UDHËZIM

Nr. 64 datë 20.2 2024

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.21, DATË 27.06.2022,
“PËR KUALIFIKIMIN E VAZHDUAR PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE TË
KULTURËS PROFESIONALE NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të nenit 12, të ligjit nr. 15/2017, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe nenit 62 të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të AFP, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 21, datë 27.06.2022 "Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimeve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Kudo në tekst togfjalëshi info@akafp.gov.al, zëvendësohet me togfjalëshin info.kualifikimi@akafp.gov.al.
2. Në nenin 3, pika 1, Shkronja "c", bëhet ndryshimi si më poshtë :
"c) Të kryejë me sukses provimin e kualifikimit përkatës, për kandidatët që aplikojnë për kategorinë "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist" dhe të demonstrojnë me sukses një seancë mësimore të hapur, teorike dhe/ose praktike, për kandidatët që aplikojnë për kategorinë "Mësues mjeshtër".

3. Në nenin 5, pika 3, Shkronja "b", bëhet ndryshimi si më poshtë:
"togfjalëshi "....të nenit 4" zvendësohet me togfjalëshin "....të nenit 3".
4. Në nenin 10, Pika 1, ndryshohet si më poshtë:
"1. Provimet e kualifikimit, vetëm për kategoritë "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist", zhvillohen me teste me shkrim.
5. Pas Kreut V, shtohet kreu V/1, me nenet 13/1, 14/1 dhe 15/1, me përmbajtje si më poshtë:

"KREU V/1

PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SEANCËN MËSIMORE TË HAPUR TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË OFRUESIT E AFP

Neni 13/1

Organizimi, realizimi dhe monitorimi i seancës mësimore të hapur për kategorinë e kualifikimit "Mësues mjeshtër"

1. AKAFPK përcakton periudhën e realizimit të seancave mësimore të hapura të kandidatëve për kategorinë e kualifikimit "Mësues mjeshtër" dhe njofton me e-mail të gjithë kandidatët.
2. Kandidati, në bashkëpunim me Drejtorinë e shkollës dhe Koordinatorin e Zhvillimit të Vazhduar Profesional (ZHVP), brenda 5 ditëve pune nga marrja e njoftimit, përcakton datën dhe orarin e realizimit të seancës mësimore të hapur dhe ia propozon (me e-mail) AKAFPK-së në adresën info.kualifikimi@akafp.gov.al
3. AKAFPK, pasi shqyrton datat e propozuara nga të gjithë kandidatët, harton kalendarin përfundimtar të realizimit të seancave mësimore të hapura dhe njofton me e-mail kandidatët, brenda 5 ditëve pune nga afati i marrjes së njoftimit nga kandidatët.
4. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKAFPK, përfaqësues nga kjo agjenci, monitorojnë realizimin e seancave mësimore të hapura të kandidatëve për kategorinë e kualifikimit "Mësues mjeshtër", në çdo ofrues të AFP ku ka kandidat të tillë.
5. Kandidati për kategorinë e kualifikimit "Mësues mjeshtër", për organizimin dhe realizimin e seancës mësimore të hapur, bashkëpunon me Drejtorinë dhe Koordinatorin e ZHVPTë shkollës.
6. Zhvillimi i seancës mësimore të hapur të kandidatëve për kategorinë "Mësues mjeshtër", bëhet në mjediset teorike dhe/ose praktike të shkollës përkatëse.
7. Drejtorja e shkollës, siguron pjesëmarrjen në seancën mësimore të hapur me përfaqësues nga drejtorja, NjZh-ja, Bordi i shkollës, personeli mësimdhënës i shkollës dhe i shkollave të tjera, komuniteti i prindërve dhe i nxënësve.
8. Drejtorja dhe Koordinatorin i ZHVP së shkollës krijojnë kushtet dhe lehtësirat e duhura si: mjedisin, mjetet dhe materialet didaktike në funksion të kërkesave që parashtron kandidati, për zhvillimin me sukses të seancës mësimore të hapur.

9. Kandidati parapërgatit mjedisin dhe mjetet mësimore në përshtatje me tematikën specifikat e seancës mësimore që do të realizojë.
10. Në përfundim të seancës mësimore të hapur, Koordinatori i ZHVP së shkollës, organizon një diskutim të lirë me pjesëmarrësit lidhur me realizimin e seancës mësimore të hapur.

Neni 14/1

Komisioni i vlerësimit të kandidatit për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër”, për realizimin e seancës mësimore të hapur.

1. Komisioni i vlerësimit të kandidatit për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër” për realizimin e seancës mësimore të hapur, përbëhet nga kryetari dhe nga 3 anëtarë.
2. Kryetari i Komisionit të vlerësimit të kandidatit është një trajner mësuesish të AFP, bashkëpunëtor i përzgjedhur nga AKAFPK.
3. Anëtarët e Komisionit janë: (1) Koordinator i ZHVP i shkollës; (2) Një mësimdhënës me përvojë i caktuar nga Drejtori i shkollës dhe (3) Një mësimdhënës i një shkolle tjetër profesionale në afërsi, i përzgjedhur në dakordësi të drejtorive të të dy shkollave.
4. Në rast se Koordinator i ZHVP është vetë kandidat për kualifikimin dhe duhet të realizojë vetë seancën mësimore të hapur, nuk mund të jetë anëtar i komisionit.
5. Në rast të mungesës së njërit nga anëtarët e komisionit, Drejtori i shkollës e zëvendëson atë me një mësues tjetër, me përvojë, të shkollës përkatëse.

Neni 15/1

Vlerësimi i kandidatit për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër”, për realizimin e seancës mësimore të hapur.

1. Vlerësimi i kandidatit për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër”, për realizimin e seancës mësimore të hapur, bëhet nga Komisioni i vlerësimit.
2. Komisioni i vlerësimit bën vlerësimin me pikë të kandidatit bazuar në Instrumentin e vlerësimit të treguar në (Shtojcën 6).
3. Kandidati që realizon seancën mësimore të hapur, vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.
4. Kandidati që realizon seancën mësimore të hapur dhe fiton më pak se 25 pikë, konsiderohet jo-fitues.
5. Komisioni mban procesverbal për vlerësimin e kandidatit, procesverbal që nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.
6. Monitoruesi, përfaqësues i AKAFPK, e përcjell në KKM procesverbalin e vlerësimit të kandidatit.
7. Rezultati i vlerësimit paraparak i komunikohet individualisht kandidatit me-mail, brenda 2 ditëve pune nga realizimi i seancës mësimore të hapur, nëpërmjet adresës: info.kualifikimi@akafp.gov.al.

8. Kandidati mund të ankohet për rezultatin e vlerësimit duke dërguar ankesën me e-mail, brenda 3 ditëve pune nga marrja e njoftimit.
 9. KKM, brenda 3 ditëve pune nga përfundimi i afatit të ankimit, shqyrton ankesën dhe njofton me e-mail kandidatin për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të seancës mësimore të hapur.
 10. KKM mban procesverbal për rezultatet e vlerësimeve përfundimtare, pas ankimeve të kandidatëve për seancat mësimore të hapura.
 11. Personat që angazhohen në procesin e vlerësimit të kandidatëve për seancat mësimore të hapura, si dhe në procesin e rivlerësimit, pas ankimit, duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit.
 12. Vlerësimi i kandidatëve për seancat mësimore të hapura, për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtrë”, pasqyrohet në regjistrin elektronik që mban AKAFPK, në kolonë të posaçme”.
6. Togfjalëshi “Kreu V” (“Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit të vazhduar profesional dhe certifikimi i mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit e AFP”), zëvendësohet me togfjalëshin “Kreu VI”.
 7. Togfjalëshi “Kreu VI” (“Dispozita të fundit”), zëvendësohet me togfjalëshin “kreu VII”.
 8. Në nenin 13, Pika 2, pas togfjalëshit “...provimi i kualifikimit përkatës”, shtohet togfjalëshi “ose nga vlerësimi i seancës mësimore të hapur”.
 9. Në nenin 13, Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Totali i pikëve të fituara nga kandidati në kualifikim llogaritet si shuma e pikëve të fituara nga (1) vlerësimi i portofolit të kualifikimit; (2) vlerësimi në provimin e kualifikimit ose (3) vlerësimi në seancën mësimore të hapur, vetëm nëse në secilën nga këto vlerësime, fiton jo më pak se 25 pikë”.
 10. Në nenin 13, Pikat 4 dhe 5, shfuqizohen.
 11. Në nenin 13, Pika 11, togfjalëshi “... për tu rifutur në provimin e kualifikimit vetëm vitin e ardhshëm dhe në këtë rast, për vlerësimin përfundimtar, do të llogariten pikët e fituara në riprovim”, zëvendësohet me togfjalëshin “...për tu rifutur në procesin e kualifikimit vetëm vitin e ardhshëm dhe në këtë rast vlerësimi përfundimtar i referohet këtij të fundit”.
 12. Rrjeshti i parë i kolonës së parë, në Shtojcën 5, ndryshohet si më poshtë:

“Shuma e pikëve të fituara nga portofoli dhe nga testi ose seanca mësimore e hapur”.
 13. Shkronjat a, c dhe d të shtojcës 5, ndryshohen si më poshtë:

“a) Pikët maksimale që fitohen nga shuma e pikëve të fituara nga portofoli i kualifikimit dhe nga testi i provimit të kualifikimit ose seanca mësimore e hapur, janë 100 pikë”.

“c) Nëse kandidati fiton më pak se 25 pikë nga vlerësimi në testin e provimit të kualifikimit ose në seancën mësimore të hapur, nuk e fiton kategorinë e kualifikimit, pavarësisht nga totali i pikëve të fituara”.

“d) Nëse kandidati grumbullon më pak se 50 pikë nga shuma e pikëve të fituara nga portofoli dhe nga testi i provimit të kualifikimit ose seanca mësimore e hapur, vlerësohet me shkallën “E” (Dobët) dhe nuk e fiton kategorinë e kualifikimit”.

14. Shtohet Shtojca 6 “Instrumenti i vlerësimit të kandidatit për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtrë”, për realizimin e seancës mësimore të hapur”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Blendi GONXHJA



Shtojca 6:

INSTRUMENTI I VLERËSIMIT TË KANDIDATIT

për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtrë”, për realizimin e seancës mësimore të hapur

Shkolla:

Mësimdhënësi:

Nr	Fushat vlerësimit	Kriteret	Pikët gjithsej	Pikët e fituara
1	Parapërgatitja e seancës mësimore (10 pikë)	Mësimdhënësi harton dokumentin planifikues të mësimit.	2 pikë	
		Mësimdhënësi planifikon në përputhje me planin e mësimdhënies së lëndës/modulit.	2 pikë	
		Mësimdhënësi siguron paraprakisht mjetet dhe materialet e nevojshme.	2 pikë	
		Mësimdhënësi përgatit paraprakisht materialet mbështetëse dhe ilustruese në mbështetje të përmbajtjes dhe në cilësinë e duhur.	2 pikë	
		Mësimdhënësi organizon siç duhet mjedisin dhe mjetet e mësimit dhe krijon kushte të përshtatshme për realizimin e tij.	2 pikë	
2	Aftësitë e buta (6 pikë)	Mësimdhënësi përdor siç duhet komunikimin verbal me nxënësit.	2 pikë	
		Mësimdhënësi përdor gjuhën trupore gjatë komunikimit.	2 pikë	
		Mësimdhënësi krijon klimë pozitive ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	2 pikë	
3	Realizimi i seancës mësimore (20 pikë)	Mësimdhënësi zbaton fazat e mësimit sipas planifikimit të bërë.	5 pikë	
		Mësimdhënësi përdor metodat mësimore të duhura për përmbajtjen e seancës mësimore.	5 pikë	
		Mësimdhënësi përdor medie mësimore/materiale ilustruese në përputhje me përmbajtjet e mësimit.	5 pikë	
		Mësimdhënësi motivon dhe aktivizon sa dhe si duhet nxënësit.	5 pikë	
4	Vlerësimi i nxënësve (8 pikë)	Mësimdhënësi vlerëson për të identifikuar nevojat e nxënësve për përmirësim.	3 pikë	
		Mësimdhënësi përdor teknikat e duhura për vlerësimin e vazhduar të nxënësve gjatë procesit mësimor.	3 pikë	
		Mësimdhënësi përdor instrumentet e duhura për vlerësimin e rezultatit të nxënësit të nxënësve.	2 pikë	
5		Mësimdhënësi krijon mjedis të sigurt dhe me kushte të përshtatshme (hapësirën, temperaturën, ndriçimin) për realizimin e seancës mësimore.	2 pikë	

Mjedisi mjetet mësimore (6 pikë)	dhe	Mësimdhënësi përdor mjetet digjitale, për të zhvilluar aftësitë digjitale dhe për të nxitur të nxënit digjital të tyre.	2 pikë	
		Mësimdhënësi sistemon mjedisin pas përfundimit të mësimit.	2 pikë	
Vlerësimi i përgjithshëm			50 pikë	

Komisioni i vlerësimit

Përfaqësues i trajnerëve (Kryetari)

(emër, mbiemër, firma)

Koordinatori i ZHVP (Anëtar)

(emër, mbiemër, firma)

Mësimdhënësi i shkollës (Anëtar)

(emër, mbiemër, firma)

Mësimdhënësi i një shkolle tjetër (Anëtar)

(emër, mbiemër, firma)

Data